



Art-Auditing

, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

TATIMET KESHILLOJNE

1. Zbritshmëria e TVSH-së

Objekti dhe rëndësia e të drejtës së zbritjes së TVSH- së

Bazuar në Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e drejta e zbritjes së TVSH-së, që ka rënduar mbi elementët e çmimit të transaksioneve të tatueshme, përbën një nga mekanizmat thelbësorë të TVSH-së.

Tatimi vetëm një herë i çmimit

Kështu, duke i dhënë tatimpaguesit të drejtën për të zbritur apo për të marrë rimbursimin e TVSH-së, e cila është derdhur në buxhetin e shtetit nga personi i tatueshëm në fazën paraardhëse, bën që çmimi i mallrave dhe shërbimeve në stadin e konsumit final të përballojë vetëm një herë tatimin.

Kujdes!

Parimi i neutralitetit fiskal përkufizohet në dispozita ligjore për të shmangur shtrembërime nga moszbatimi i të drejtës së zbritjes; konkretisht nenet 68 deri 84 të Ligjit të cilat parashikojnë kushtet, kufizimet, dhe rregullimet e parashikuara për ushtrimin e të drejtës së zbritjes.

Zbritja e TVSH-së

Në përputhje me këto parime, një person i tatueshëm lejohet të zbresë TVSH-në që ka rënduar çmimin e një malli apo të një shërbimi **përderisa ky mall apo shërbim është përdorur për realizimin e një transaksioni të tatueshëm me të drejtë zbritjeje**, me rezervën që nuk është objekt i ndonjë kufizimi apo përjashtimi të veçantë, shprehimisht i përcaktuar në ligj.

Kujdes!

Një person i tatueshëm nuk lejohet të zbresë TVSH-në që ka rënduar çmimin e një malli apo shërbimi, përderisa ky mall ose shërbim është përdorur për kryerjen e transaksioneve të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit.

Transaksione të përziera

Kur një sipërmarrje realizon në të njëjtën kohë, transaksione brenda fushës së zbatimit të TVSH (të tatueshme me TVSH, apo të përjashtuara) ose jashtë saj, ajo duhet të dallojë mallrat dhe shërbimet e blera, të cilat do të përdoren përkatësisht për secilën nga kategoritë e transaksioneve, me qëllim aplikimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së.

2. Kriteret formale për ushtrimin e të drejtës së zbritjes së TVSHsë

Në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e drejta e zbritjes së TVSH-së e përfshirë në çmimin e blerjes së një malli/shërbimi, ushtrohet prej blerësit kur TVSH-ja bëhet e kërkueshme tek furnizuesi. Kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e të drejtës së zbritjes së TVSH-së janë si më poshtë:

Dokumentimi

TVSH-ja e zbritshme është TVSH e shënuar në faturën tatimore të lëshuar nga furnizuesi, si dhe TVSH e paguar në import, e shënuar në dokumentin doganor të importit (deklaratë doganore).

Për plotësimin e deklaratës së TVSH-së, personi i tatueshëm duhet të zotërojë faturën e blerjes me TVSH - për blerje të kryera në vend, që e tregon atë si blerës, - ose çdo lloj dokumenti tjetër, si deklarata e importit, që e tregon atë si marrësin e mallrave të importuara.

Kujdes!

Zbritja e TVSH-së në blerje kërkohet mbi bazën e faturës tatimore origjinale të lëshuar prej furnizuesit dhe të plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.

Për qëllime të zbritjes së TVSH-së, **konsiderohet e vlefshme edhe kopja e noterizuar e faturës së blerjes (në rast se fatura origjinale humbet), me kusht që shitësi të zotërojë kopjen e tij të faturës dhe ta ketë deklaruar atë.** Pa këtë faturë nuk ushtrohet e drejta për të zbritur TVSHnë e paguar, ose për t'u paguar në blerje.

Kriteret e personit të tatueshëm

- a) Për zbritjen e TVSH-së, lidhur me shitjet e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve, të zotërojë një faturë të hartuar në përputhje me nenet nga 96 deri në 105 të Ligjit;
- b) Për zbritjen e TVSH-së, lidhur me furnizimet kundrejt pagesës, kur kemi të bëjmë me vetëfurnizim, duhet të jetë dokumentuar me faturë;
- c) Për zbritjen e TVSH-së, lidhur me importimet e mallrave, duhet të zotërojë një deklaratë që provon importimin, të lëshuar në momentin e çlirimit për qarkullim të lirë të mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë;